

FINANCA

BULETINI MUJOR | KORRIK 2025



BORXHI PUBLIK ARRIN NË 54.02% NË FUND TË 6-MUJORIT TË PARË TË VITIT 2025

Borxhi publik vijon tendencën rënëse. Të dhënat e 6-mujorit të parë të vitit 2025 tregojnë se niveli i borxhit publik i matur ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto arriti në 54.02%, nga 54.21% që ishte në fund të vitit

2024. Rënia e borxhit publik tregon për një politikë të kujdesshme fiskale, si dhe për një mirëmenaxhim të portofolit në tërësi. Objektivi kryesor i Ministrisë së Financave do të vijojë të jetë konsolidimi fiskal, mbajtja nën kontroll e shpenzimeve dhe rritja e të ardhurave, me qëllim uljen e trajektores së borxhit publik.

► LEXO MË SHUMË

PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS PARAPRAKE TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR JANAR-QERSHOR 2025

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar – Qershor 2025 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën Janar – Qershor 2025, arritën në rreth 366 miliardë lekë, një realizim në masën 100.6 % të planit të periudhës. Krahastuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, u mbledhën rreth 22.8 miliardë lekë më

shumë ose 6.7 % më shumë. Në terma vjetorë, të ardhurat totale për 6 mujorin e vitit 2025 u realizuan në masën 48.3% të planit vjetor. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 6 mujore të vitit 2025, arritën në rreth 332.5 miliardë lekë me një realizim në masën 99.8% e planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, ky zë ka rezultuar 14.1% më i lartë ose rreth 41.2 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet e përgjithshme për 6 mujorin e vitit 2025 u realizuan në masën 40.3% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 40.2% sipas Aktit Normativ Nr. 6 datë 11.06.2025.

► LEXO MË SHUMË



“BASHKËPUNIMI ME SEKTORIN BANKAR, I RËNDËSISHËM PËR ZBATIMIN ME SUKSES TË GARANCISË SOVRANE PËR BUJQËSINË”

Ministri i Financave mori pjesë në tryezën e diskutimit me përfaqësues të sektorit bankar lidhur me garancinë sovranë për bujqësinë, organizuar nga MF dhe BSH, ku theksoi se garancia nuk është vetëm një instrument financiar, por një mundësi reale për të ndërtuar një model të ri zhvillimi për bujqësinë dhe ekonominë, ku bashkëpunimi me sektorin bankar është një nga faktorët kyç të suksesit. Skema e garancisë sovranë do të mbështesë bujqësinë me një fond prej rreth 3 miliardë lekësh apo 30 milionë euro dhe do të vihet në dispozicion në bashkëpunim me sektorin bankar. Zbatimi me efikasitet i saj kërkon një pjesëmarrje aktive edhe nga vetë fermerët dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në të gjithë vendin. Z. Malaj tha se qeveria shqiptare dhe Ministria e Financave mbeten të angazhuara për të krijuar mjedisin e duhur financiar, ligjor dhe rregullator me qëllim nxitjen e investimeve në sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik.

► LEXO MË SHUMË

“SHQIPËRIA 2030 – SFIDAT DHE ANGZHIMET VENDORE”– PERFORMANCA E BASHKIVE



Ministri Petrit Malaj bëri një prezantim të gjendjes financiare të bashkive, në takimin “Shqipëria 2030 – Sfidat dhe angazhimet vendore”, gjatë diskutimit mbi performancën e bashkive dhe grantit të performancës.



Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, në kuadër të masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror. Referuar të dhënave, Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza” TIA ka përballuar gjatë vitit 2024 një fluks (në hyrje – dalje) prej 10.7 milion pasagjerë, ndërkohë që pritshmëritë janë që në vitin 2025 ky numër

MINISTRI I FINANCAVE ZHVILLOI NJË VIZITË INSPEKTIMI NË DEGËN DOGANORE NË RINAS

Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave, z. Genti Gazheli, zhvilluan një vizitë inspektimi në Degën Doganore Rinas, në Aeroportin

të shkojë deri në 12 milionë pasagjerë. Gjatë kësaj vizite, Ministri Malaj u shpreh se turizmi është një nga sektorët kyç për zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe kontribuon me rreth 25 % në Prodhimin e Brendshëm Bruto, ndërsa punëson mënyrë direkte apo indirekte rreth 10 % të fuqisë punëtore në vendin tonë. Ministri Malaj tha se objektivi primar duhet të jetë garantimi i procesimit të shpejtë të udhëtarëve dhe zbatimi me përgjegjshmëri i kontrollit dhe procedurave doganore, si për udhëtarët, ashtu edhe për biznesin.

► LEXO MË SHUMË

MINISTRI MALAJ TAKOHET ME MINISTRIN E FINANCAVE TË KOSOVËS, THELLIM TË BASHKËPUNIMIT MES SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Ministri Petrit Malaj zhvilloi një takim me Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës, z. Hekuran Murati. Ky takim u zhvillua në kuadër të një vizite të përbashkët inspektimi që dy ministrat patën në degën doganore Morinë-Vermicë, një nga pikat më të rëndësishme doganore mes Shqipërisë dhe Kosovës. Ministri Malaj vlerësoi se ndër vite bashkëpunimi mes dy vendeve ka qenë i

qëndrueshëm dhe gjithnjë në rritje. Falë këtij bashkëpunimi, tha Z. Malaj, rezultate konkrete janë shënuar edhe sa i përket doganave, çka ka sjellë lehtësim të tregtisë mes dy vendeve, standardizim të procedurave mes tyre dhe si rrjedhojë më shumë zhvillim ekonomik. Nga ana e tij, Ministri Murati theksoi se lehtësitë sa i përket procedurave dhe ulja e kostove janë ndërjet nga ana e bizneseve dhe tregtarëve, çka ka ndikuar në rritjen e shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve tona. Z. Murati tha se Shqipëria është ndër partnerët kryesorë tregtarë për Republikën e Kosovës dhe ky bashkëpunim pritet të thellohet edhe më shumë.

► LEXO MË SHUMË



NDRYSHIMET NË BUXHETIN 2025, MALAJ: MENAXHIM TË PËRGJEGJSHËM E TRANSPARENT TË FINANCAVE PUBLIKE

Ministri i Financave paraqiti në Kuvend Aktin Normativ nr. 6, datë 11.06.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 115/2024 ‘Për buxhetin e vitit 2025’, i ndryshuar”. Hartimi i Aktit erdhi si rezultat i një analize gjithëpërfshirëse të MF mbi ecurinë pesëmujore të të ardhurave dhe shpenzimeve, e cila evidentoi nevojën për ndërhyrje në strukturën e buxhetit, për ta përpthur atë sa më mirë me progresin e projekteve në

terren dhe për të siguruar alokimin më eficient të burimeve drejt prioritetëve që kanë demonstruar performancë më pozitive. Ministri Malaj u shpreh se rishikimi i Buxhetit përmes Aktit Normativ përshpejton rialokimin e fondeve drejt projekteve më strategjike dhe garanton respektimin e angazhimeve për disiplinën fiskale e buxhetore. Këto ndryshime, theksoi z. Malaj, forcojnë më tej angazhimin për menaxhim të përgjegjshëm e transparent të financave publike, pasi sigurojnë jo vetëm vijimin e trajektores rënëse të borxhit publik në raport me PBB-në, por edhe konsolidimin e themeleve për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës.

► LEXO MË SHUMË



MINISTRIA E FINANCAVE NIS KONSULTIMIN PUBLIK TË PROJEKTLIGJIT PËR “RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME”

Ministria e Financave ka hedhur për konsultim

publik projektligjin për “Rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”. Përmes këtij projektligji synohet të krijohet një kuadër ligjor për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme të individëve dhe personave juridikë, duke iu dhënë mundësi që përmes një tatimi të reduktuar në masën 5% të mund të bëjnë përshtatjen e vlerës së pronave me çmimet aktuale të tregut. Zbatimi, me miratimin përkatës pritet të hyjë në fuqi në datë 1 janar 2026. Ftojme të gjitha palët e interesuara që të marrin pjesë aktivisht me komentet e tyre brenda një periudhe 1 mujore, për t'i bërë sa më efikase në zbatim. Dokumentet mund të aksesohen në linkun përkatës: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/849>

► LEXO MË SHUMË



MINISTRIA E FINANCAVE HAP KONSULTIMIN PUBLIK TË PROJEKTLIGJIT “PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË BANESAVE NGA TËRMETET”

Ministria e Financave ka hedhur për Konsultim Publik projektligjin “Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet”. Hartimi i këtij projektligji mbështetet në përvojat e suksesshme të disa vendeve dhe ka si qëllim zvogëlimin e ndikimeve financiare, fiskale dhe ekonomike që mund të shkaktojnë fatkeqësitë natyrore. Ftojme të gjitha palët e interesuara që të marrin pjesë aktivisht me komentet e tyre, brenda një periudhe 1 mujore. Projektligji mund të aksesohet lehtësisht në linkun: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/851>

► LEXO MË SHUMË



KONSULTIM PUBLIK I PROJEKTVENDIMIT “PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME TË PASURISË SË PALUAJTSHME “NDËRTESTA”, LLOGARITJEN E TAKSËS MBI NDËRTESTËN DHE PAGESËN E SAJ”

Ministria e Financave ka hedhur për konsultim publik projektvendimin “Për miratimin e metodologjisë, rregullave dhe procedurave për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesta”, llogaritjen e taksës mbi ndërtesën dhe pagesën e saj”. Projektvendimi paraqet edhe gnimet e reja mesatare referuese për metër katror, sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për banesat që ndodhen në disa qarqe të vendit, përjashtuar këtu Bashkinë Tiranë. Ky është hapi i parë ndaj reformimit të plotë të sistemit të taksimit për të gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri. Zbatimi, me miratimin përkatës pritet të hyjë në fuqi në datë 1 janar 2026. Ftojme të gjitha palët e interesuara, që të marrin pjesë aktivisht me komentet e tyre brenda një periudhe 1 mujore, për t'i bërë sa më efikase në zbatim. Dokumentet mund të aksesohen në linkun përkatës: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/850>

► LEXO MË SHUMË



RAPORTI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS LIDHUR ME LLOGARIDHËNIEN PËR SHPENZIMET DHE FINANCAT PUBLIKE (PEFA) PËR SHQIPËRINË

Ministria e Financave, në bashkëpunim me ekipin e ekspertëve dhe Delegacionin të Bashkimit Europian, prezantuan Raportin e Vlerësimit të Performancës lidhur me Llogaridhëniën për Shpenzimet dhe Financat Publike (PEFA) për Shqipërinë. PEFA ofron një analizë të thelluar të performancës së sistemit të

menaxhimit financiar publik në vend dhe shërben si një mjet i rëndësishëm për forcimin e transparencës, llogaridhënie dhe efikasitetit në menaxhimin e financave publike, duke kontribuar në avancimin e reformave të vazhdueshme dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Zhvillimet kryesore përfshijnë ekzekutimin e qëndrueshëm të buxhetit me devijime minimale, një proces të mirëstrukturuar buxhetor i mbështetur nga planifikimi fiskal afatmesëm, kontrolle të forta të brendshme financiare dhe organizimin e auditimit, administrim efikas të taksave, menaxhim efektiv të borxhit dhe likuiditetit, si dhe objektiva të qarta për shërbimet publike me tregues performancë të matshëm.

► LEXO MË SHUMË